



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 800/7 prot.

Datë 22.04.2026

**V E N D I M**

**Nr. 525/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.04.2026 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Evita” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në

datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës mbi pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Evita” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK me NIPT J93610823R dhe adresë: LAGJA 5, Tiranë

Operatori ekonomik “Evita” SHPK me NIPT L31714005J dhe adresë: Rruga Sami Frashëri, Nr. Pasurie 7/120- N1, Zona Kadastrale 8270, Vol. 28, faqe 155, Tiranë

Operatori ekonomik “SWISSMED” SHPK, me Nipt. K81323024G dhe adresë Njesia Bashkiake nr.11, Rruga Dritan Hoxha, Ndertesa 92, seksioni 4, Hyrja 28, Kodi Postar 1026, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.  
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

I.5. Operatori ekonomik “SWISSMED” SHPK ka respektuar hapat procedural për të bërë të mundur ushtrimin e të drejtës së ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 08.10.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a

II.2. Në datën 02.02.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 19.02.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. "BIOMETRIC ALBANIA" SHPK	0 lekë	s'kualifikuar
2. "KRIJON" SHPK	62,928,000 lekë	s'kualifikuar
3. "MEDFAU" SHPK	63,480,000 lekë	s'kualifikuar
4. "SWISSMED" SHPK	71,484,000 lekë	kualifikuar
5. "E v i t a" SHPK	67,620,000 lekë	s'kualifikuar

II.4. Në datën 19.02.2026 operatori ekonomik "MEDFAU" SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

*"1. Operatori ekonomik "MEDFAU" Shpk, Nipt J93610823R me dokumentacionin e paraqitur rezulton se nuk përmbush kërkesën 2.3.5 të kapacitetit teknik për kualifikim të përcaktuar në dokumentet e tenderit ku thuhet:*

*"Për të gjithë artikujt (kite, reagentë, materiale mjekësore etj.) e ofruar dhe që janë pjesë e setit sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike/specifikimi i materialeve), te paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet). Operatori ekonomik duhet të markoje në katalogun perkates produktet që ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit"*

*Konkretisht në përmbushje të kriterit të sipërcituar operatori ekonomik ka paraqitur në SPE dokumentat me emërtimet "Katalogu RP500", "Operator guide rp 500", "Broshure rp500" në të cilin janë të përfshira të dhënat për artikujt të cilët janë pjesë e setit sipas dhe ofertës teknike të paraqitur nga OE në përmbushje të kriterit 2.3.15. Nga verifikimi i këtyre katalogjeve konstatohet që artikujt pjesë e setit nuk përmbushin të gjitha specifikimet teknike pasi nuk përfshijnë parametrin "UREA", parametër ky i kërkuar në dokumentat standartë të kësaj procedure.*

*Për sa më sipër "MEDFAU" Shpk, Nipt J93610823R skualifikohet.*

*2. Operatori ekonomik "MEDFAU" Shpk, Nipt J93610823R, me dokumentacionin e paraqitur rezulton se nuk përmbush kërkesën 2.3.7 të kapacitetit teknik për kualifikim të përcaktuar në dokumentet e tenderit ku thuhet:*

*"Për pajisjet e astrupogramës (makinat e astrupogramës) të ofruara në përdorim, që do të shërbejnë për matjen e gazeve dhe elektroliteve në gjak, te paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që*

përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun perkates produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të percaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nepermjet sistemit elektronik të prokurimit”

Konkretisht në përmbushje të kriterit të sipërcituar operatori ekonomik ka paraqitur në SPE dokumentin me emërtimin “Katalog RP500”, “Broshure RP500”, “Operator Guide RP500” në të cilët janë të përfshira të dhënat për pajisjet e astrupogramës të ofruara në përdorim sipas dhe ofertës teknike të paraqitur nga OE në përmbushje të kriterit 2.3.15. Nga verifikimi i këtyre katalogjeve konstatohet që pajisjet e astrupogramës të ofruara në përdorim nuk përmbushin të gjitha specifikimet teknike pasi nuk përfshijnë kryerjen analizës së “UREA-s”, analizë kjo e kërkuar në shtojcën 6 të specifikimeve teknike të DST.

Për sa më sipër “MEDFAU” Shpk, Nipt J93610823R skualifikohet”.

II.5. Në datën 19.02.2026 operatori ekonomik “Evita” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon

Operatori ekonomik “EVITA” Shpk, Nipt L31714005J, me dokumentacionin e paraqitur rezulton se nuk përmbush kërkesën 2.3.15 të kapacitetit teknik për kualifikim të percaktuar në dokumentet e tenderit ku thuhet: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për artikujt e kërkuar (për artikujt e përfshirë në SET si dhe për Makinat e Astrupogramës)\*, në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese për produktet.

\*Sqarim: Operatori Ekonomik ofertues, në mënyrë që të konkludohet me një vlerësim sa më të saktë dhe mosdiskriminues nga AK, duhet të paraqesë 2 (dy) Oferta Teknike, ku njëra Ofertë Teknike pasqyron artikujt që janë pjesë e Set-it, objekt i kësaj kontrate, dhe një Ofertë Teknike tjetër për Makinat e Astrupogramës, që do të ofrohen në përdorim, dhe do të shërbejnë AK për të vlerësuar drejtë përmbushjen e specifikimeve teknike për makinat e astrupogramës.”

Konkretisht nga verifikimi i dokumentacionit zyrtar të prodhuesit ROCHE, katalogu me emërtimin “Evita\_katalog\_Cobas\_221” i ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik pjesmarrës, në faqet 46-47 evidentohet që procedura e matjes së parametrave kryhet me anë të elektrodave ndërsa procedura e kalibrimit kryhet me anë të solucionëve “S2 Fluid Pack” dhe “S3 Fluid Pack A”, dhe në nga verifikimet e kryera procedura e kalibrimit bëhet para procedurës së matjes së parametrave me qëllimin e marrjes së një rezultati shumë të saktë të parametrave të kërkuar, pra si përfundim janë procedura të lidhura me njëra tjetrën.

Operatori ekonomik “EVITA” Shpk, Nipt L31714005J në përmbushje të kërkesës për ofertën teknike të artikujve të përfshirë në set ka ngarkuar në SPE dokumentin me emërtimin “Evita Formulari Ofertes Teknike Seti reagenteve”, dokument i cili përmban produktet me emërtimet “S1 Rinse Solution”, “S2 Fluid Pack” dhe “S3 Fluid Pack A. Referuar kësaj oferte teknike, produkti me emërtimin “S1 Rinse Solution” të cilin OE e ka përshkruar specifikimet teknike të tij dhe thotë që është “Solucion për shpëlarjen e elektrodave S1”,

fakt i cili konfirmohet dhe në deklaratën e konformitetit të ROCHE ku thuhet që produkti me emërtimin “S1 Rinse Solution” është solucion për larjen tubave dhe sistemit Cobas b 221. Ndërsa për sa i përket produkteve “S2 Fluid Pack” që referuar specifikimeve në këtë ofertë teknike është Solucion për kalibrimin e parametrave elektroliteve dhe gazeve ne gjak S2 dhe “S3 Fluid Pack A” që referuar specifikimeve në këtë ofertë teknike është Solucion për kalibrimin e Glu/Lac/Urea, specifikimet teknike të këtyre artikujve të cilat vihen re dhe në katalogun e ngarkuar në SPE me emërtimin “Evita\_katalog\_Cobas\_221”, në faqet 46-47, ku konstatohet që këto artikuj janë solucione për kalibrim dhe janë artikuj pjesë e setit.

Bazuar në konstatimet e sipërcituara arrihet në përfundimin që oferta teknike e paraqitur nuk përmban të gjithë artikujt që janë pjesë e setit pasi OE nuk ka listuar në këtë ofertë teknike “elektrodat” me anë të cileve kryhen matjet e parametrave referuar kjo dhe katalogut me emërtimin “Evita\_katalog\_Cobas\_221” të prodhuesit ROCHE ku përshkruhet procedura e matjes së parametrave. Gjithashtu për të përforcuar dhe më shumë këtë fakt sjellim në vëmendje dhe Listën e cmimeve të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik në të cilën konstatohet që artikujt përbërës të setit për një analizë janë “Kite reagente elektroda për matjen e gazrave dhe elektroliteve në gjak”, cka konfirmon dhe njëherë që elektrodat janë të pjesë dhe për më tepër janë objekt faturimi dhe detyrimisht këto elektroda duhet të ishin listuar në ofertën teknike të paraqitur.

Në përfundim të arsyesimit dhe fakteve të parashtruara më sipër gjykojmë që oferta teknike e paraqitur nga operatori ekonomik ofertues nuk përfshin të gjithë artikujt e setit sipas kërkesës në kriterin 2.3.15 sepse në të janë paraqitur vetëm artikujt “S1 Rinse Solution”, i cili është solucion për larjen tubave dhe sistemit Cobas b 221, dhe “S2 Fluid Pack” dhe “S3 Fluid Pack A të cilët shërbejnë për kalibrim e pajisjes, për rrjedhojë “EVITA” Shpk, Nipt L31714005J nuk përmbush kriterin e sipërcituar.

Për sa më sipër “EVITA” Shpk, Nipt L31714005J skualifikohet”

II.6. Në datën 02.03.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraparak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.7. Në datën 12.03.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa e operatorit ekonomik “MEDFAU” SHPK me numër ankimimi elektronik A/2026/6411, dhe me Nr. 800/2026 Prot., datë 12.03.2026 ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me pretendimet si vijon:

“.....Kompania Medfau Sh.p.k si nje perfaqesi I kompanise lider SIEMENS kerkojme qe oferta jone te kualifikohet si nje oferte e cila ploteson te gjitha kushtet sipas DST.

Parametri UREA eshte nje parameter I cili nuk ka asnje lloj impakti ne Astrupograme( analizimi I gazrave ne gjak). Me poshte edhe nje argumentim per kete bashke me disa referenca te studimeve boterore :

1. Perfshirja e BUN/urese ne analizatoret e gazrave te gjakut ka dobi klinike minimale pasi dhezuesit autoritative nderkombetare si KDIGO (1) ((Kidney Disease: Improving Global Outcomes)

cilesojne se BUN nuk eshte markues paresor per funksionin e veshkave ndaj matja rutine e

ketij parametri duhet te mbeshtetet ne rezultatet e laboratorit qendror. Autoriteti KDIGO dhe American

College of Radiology (2) rekomandon qe vleresimi i demtimit akut te veshkave (AKI) bazohet te kreatinina dhe vellimi i urines, jo te BUN-i.

1- Notice. (2012). *Kidney International Supplements*, 2(1), 1. <https://doi.org/10.1038/kisup.2012.1>

2- American College of Radiology. (2024). *ACR manual on contrast media (Version 2024)*. American College of Radiology.

2. *Perveç vleres se kufizuar klinike te BUN si tregues primar i funksionit renal, evidenca eksperimentale tregon se matja e tij ne platforma BGA (blood gas analyser) mund te paraqese devijime sistematike. Studimi i publikuar ne Journal of Clinical Medicine (2023) (3) demonstroi se ne perqendrimet prane vlerave te dendimmarrjes klinike per BUN, diferencat midis kampioneve serum dhe gjak total I heparinizuar tejkalojne kriteret e lejueshme te gabimit total (TEa), duke e bere rezultatin klinikisht te pabesueshem*

3- Lim, H.-J., Lee, S.-Y., & Choi, H.-J. (2023). *Evaluation of the Accuracy of Cr and BUN Using the ABL90 FLEX PLUS Blood Gas Analyzer and the Equivalence of Candidate Specimens for Assessment of Renal Function*. *Journal of Clinical Medicine*, 12(5), 1940. <https://doi.org/10.3390/jcm12051940>.

4- *Përfshirja e parametrut Urea për të gjithë sasinë e seteve të kiteve të kërkuara, rezulton e pajustificuar nga pikëpamja klinike, shkencore dhe e mjekësisë së bazuar në evidencë. Kjo kërkesë, e vendosur si e detyrueshme në të gjithë e sasinë e panelit bazë, është teknikisht e pajustificuar, ekonomikisht jo-eficiente, dhe ligjërish jo proporcionale, duke krijuar rrezik real për kufizim të panevojshëm të konkurrencës.*

*Astrupogrami (gazet në gjak) është një ekzaminim diagnostik me qëllim të qartë dhe të përcaktuar, i orientuar drejt vlerësimit të oksigjenimit, ventilimit dhe ekuilibrit acido-bazik në situata akute dhe emergjente, dhe si i tillë përfshin parametra të tillë si pH, PO<sub>2</sub>, PCO<sub>2</sub>, HCO<sub>3</sub><sup>-</sup>, Base Excess (BE), saturimi i oksigjenit dhe, në raste të veçanta, laktati dhe elektrolitet. Në këtë kontekst, urea nuk ka gjithmonë rol funksional në interpretimin e gazrave të gjakut, nuk ndikon në analizën e çrregullimeve acido-bazike apo respiratore dhe nuk kontribuon në vendimmarrjen klinike emergjente për të cilën ky ekzaminim kryhet. Parametri UREA është një tregues i funksionit renal me ndryshime në pergjithësi jo akute dhe në asnjë mënyrë nuk ka asnjë lloj lidhje me gazrat në gjak dhe vendosja e këtij parametri si e detyrueshme është një faktor që cenon konkurrencën e lire dhe duke favorizuar një prodhues të caktuar.*

*Gjithashtu ne kerkojme edhe informacion mbi ndryshimin e keti parametri ( vendosjen e tij ne DST ne momentet e fundit) pas kerkeses per sqarim te kompanise SWISSMED ( qe per ironi eshte edhe i fituesi” I kesaj procedure prokurimi???) . Ndryshimi eshte kryer ne momentet e fundit ( edhe pasi ka kaluar afati I ankimimeve ) duke mos na dhene mundesine per ankim ose sqarim per parametrin UREA.*

*Ju veme ne dijeni qe eshte I njejtj AK- OBP qe ka publikuar perseri nje procedure te ngjashme me obekt iBlerje Materiale Mjekimi per funksionimin e Shërbimit të Kardiokirurgjisë” në Q.S.R.T ëShefqet Ndroqi i ndarë në 7 lote, për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”*

REF-74963-02-02-2026

*Loti 5 Kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma.*

REF-74975-02-02-2026

*Edhe ketu parametri UREA kerkohet per cdo analizator dhe pas ankesave te operatoreve ekonomike ne kete rast AK- OBP ka pranuar qe parametri UREA eshte I panevojshem, kjo e shprehur ne vendimin e OBP me numer 500/25 date 03.03,2026 ku konkretisht nder te tjera shprehet:*

*Percaktimi I Uese ne Astrupograme nuk eshte I domosdoshem .*

*Kerkojme nga AK-OBP dhe KPP qe te mbajne te njejtin qendrim duke e klasifikuar parametrin UREA si jo te dosmosdoshem dhe duke klasifikuar oferten e kompanise Medfau Sh.p.k si nje oferte te vlefshme*

*Sa me siper kerkojme nga ana juaj kualifikimin e ofertes tone duke e konsideruar parametrin UREA si nje parameter jo te dosmosdoshem per analizat e gazrave ne gjak.....”*

II.8. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 800/1 prot., datë 13.03.2026, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 800 prot, datë 12.03.2026.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik është depozituar Formulari i paraqitjes së Argumentave nga operatori ekonomik “SWISSMED” SHPK, protokolluar me tonën nr.800/2, datë 18.03.2026

II.10. Nëpërmjet shkresës me nr. 3205/29 prot., datë 23.03.2026, protokolluar me tonën me shkresën nr. 800/3 prot., datë 24.03.2026, është depozituar nga autoriteti kontraktor në rrugë elektronike vendimi i KSHA-së nr.50/2026 datë 24.03.2026

I njëjti vendim është përcjellë nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr.3205/30 prot., datë 24.03.2026, protokolluar me tonën nr.800/4 prot., datë 26.03.2026.

Referuar këtij vendimi konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranim të ankesës.

II.11. Në datën 12.03.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2026/6414, dhe me Nr. 815/2026 Prot., datë 13.03.2026 e operatori ekonomik “Evita” SHPK ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike me pretendimet si vijon:

*“.....Operatori ekonomik EVITA SHPK paraqet këtë ankim në lidhje me vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, i cili ka konsideruar ofertën tonë si të papranueshme mbi bazën e një interpretimi teknik të pasaktë lidhur me përbërjen e reagentëve dhe komponentëve setit së Astrupogramës.*

*Vlerësimi i bërë nga Komisioni bazohet në një interpretim që nuk përputhet me*

dokumentacionin teknik të prodhuesit të aparaturës dhe me praktikën e përdorur në laboratorët klinikë për pajisje të këtij lloji.

Në veçanti, Komisioni ka konsideruar se elektrodën duhet të përfshihen si pjesë e setit të reagentëve, ndërkohë që sipas dokumentacionit teknik të prodhuesit dhe standardeve të përdorura për pajisjet e analizës së gazrave në gjak, elektrodën janë komponentë të aparaturës analitike dhe jo pjesë e reagentëve të analizës.

Ky interpretim teknik ka çuar në një vlerësim të gabuar të ofertës sonë dhe në përjashtimin e saj nga procedura, duke krijuar një situatë që bie ndesh me parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe vlerësimin objektiv të ofertave.

I.

Në pikën 2.3.15 të Dokumenteve Standarde të Tenderit kërkohet që operatori ekonomik të paraqesë ofertë teknike për artikujt e përfshirë në setin e reagentëve si dhe ofertë teknike për aparaturat e astrupogramës.

Operatori ekonomik EVITA Shpk ka përmbushur plotësisht këtë kërkesë duke paraqitur:

- ofertën teknike për artikujt që përbëjnë setin e reagentëve (Evita Formulari Ofertes Teknike Seti reagenteve)
- ofertën teknike për aparaturat e astrupogramës (Evita Formulari Ofertes Teknike Aparat - Cobas b221)
- katalogun teknik të prodhuesit për aparaturën e Astrupogramës. (Evita Katalog Cobas b 221 operator manual; Evita Katalog b221 FQA)
- katalogun teknik të prodhuesit për setin e reagentëve. (Evita Catalog 2012)

Ne Dokumenteve Standarde të Tenderit / Kriteret e Veçanta të Kualifikimit / pika 2.3.15 kërkohet në mënyrë eksplicite si më poshtë:

15. Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për artikujt e kërkuar (për artikujt e përfshirë në SET si dhe për Makinat e Astrupogramës)\*, në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emertimi i katalogut të artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatëse për produktet.

Për sa më lart, Operatori Ekonomik Evita SHPK ka përcaktuar qartë përbërjen e setit të Reagentëve

/ Solucioneve (S1, S2, S3), me sasi të domosdoshme për realizimin e 276.000 testeve objekt i prokurimit bazuar në katalogun e aparaturës dhe reagentëve. Për më tepër, OE Evita SHPK në formularin e “Evita Vetedeklarim mbi sasine dhe grafikun e levrimit të mallit (Seti i Reagentëve)” ka deklaruar me përgjegjësi të plotë (fjalë e fundit) se “Të gjitha aparaturat do të mbulohen me furnizim me elektroda dhe aksesorët e nevojshëm gjatë gjithë periudhës së marrëveshjes kuadër”. Kjo deklaratë shpjegon qartë që elektrodën dhe aksesorët e tjerë janë pjesë përbërëse e aparaturës që marrin pjesë në realizimin e testimit por kurrsesi nuk janë pjesë përbërëse e setit të reagentëve/solucioneve. Pikërisht për këtë, matja e Astrupogramës me Aparatin cobas b221 quhet metodë matje me SOLUCIONE.

Ndoshta KVO ka interpretuar ofertën tonë në mënyrë të gabuar duke patur parasysh sistemin Cartridge i cili ka të përfshirë elektrodën dhe reagentët brenda Cartridget.

Për rrjedhojë, interpretimi i bërë nga KVO për ofertën tonë në fazën e vlerësimit, është i gabuar kjo mbase duke patur parasysh sistemin Cartridge i cili ka të përfshirë elektrodën dhe reagentët brenda

Cartridget.

II.

*Përbërja e setit të reagentëve përcaktohet nga teknologjia e aparaturës Analizatorët e gazrave dhe elektroliteve në gjak (blood gas analyzers), si aparatura Cobas b221, funksionojnë mbi bazën e elektrodave dhe sensorëve elektrokimikë të inkuorporuar në aparaturë dhe solucioneve të reagentëve që përdoren për kalibrimin dhe rezultatin.*

*Në Sistemet me Solucione dallohen qartë dy kategori komponentësh:*

### *1. Reagentët e analizës*

*Reagentët janë materialet konsumuese që përdoren drejtpërdrejt për funksionimin analitik të sistemit dhe përfshijnë zakonisht:*

- *solucionet e kalibrimit*
- *solucionet e shpëlarjes*
- *solucionet e stabilizimit të sistemit*

*Në rastin e aparaturës Cobas b221, këta reagentë janë:*

- *S1 Rinse Solution*
- *S2 Fluid Pack*
- *S3 Fluid Pack A*

*Në këto solucione përcaktohet sasia e nevojshme për realizimin e testeve dhe konsumimi i tyre është në varësi të numrit të ekzaminimeve dhe kanë një jetëgjatësi 42 ditë nga momenti që vendosen në aparat (dokument bashkelidhur Cobas b 221 POC system faqe 4) dhe përdoren për:*

- *kalibrimin e sensorëve të sistemit*
- *stabilizimin e matjeve*
- *shpëlarjen e sistemit fluidik*

*Dhe për këtë arsye klasifikohen si reagentë të analizës laboratorike.*

### *2. Komponentët teknikë të aparaturës*

*Elektrodat në analizatorët e gazrave në gjak janë sensorë elektrokimikë të integruar në sistemin matës të aparaturës.*

*Funksioni i tyre është:*

- *detektimi elektrokimik i parametrave si pH, pCO<sub>2</sub>, pO<sub>2</sub>, elektrolitet etj. Megjithatë, nga pikëpamja laboratorike dhe teknologjike:*
- *elektrodat janë komponentë të sistemit të aparaturës.*
- *elektrodat nuk janë reagentë*
- *elektrodat nuk janë materiale konsumuese për çdo analizë*

*Ato kanë cikël zëvendësimi teknik të përcaktuar nga prodhuesi dhe zakonisht ndërrohen në intervale disa mujore.*

*Sipas specifikimeve teknike të prodhuesit për aparaturën Cobas b221:*

- *pH / pCO<sub>2</sub> / pO<sub>2</sub>: zakonisht 9–12 muaj*
  - *ISE elektrodat (Na, K, Cl, Ca): rreth 6–12 muaj, në varësi të volumit të analizave.*
- (dokument bashkelidhur Cobas b 221 POC system faqe 4)*

*Për këtë arsye ato trajtohen në praktikën laboratorike si komponentë të mirëmbajtjes së aparaturës dhe jo si reagentë të analizës.*

*Si konkluzion: në analizatorët e gazrave në gjak:*

- *reagentët e setit të analizës janë solucionet e kalibrimit dhe shpëlarjes*
- *elektrodat janë komponentë teknikë të aparaturës*

*Për rrjedhojë, përfshirja e solucioneve S1, S2 dhe S3 në ofertën teknike të Evita SHPK përbën paraqitjen e plotë të reagentëve të setit të analizës, në përputhje me mënyrën e funksionimit të sistemit dhe monitorimit të sasisë për testet e kërkuara.*

### *III.*

*Funksionimi i plotë i aparaturës është garantuar nga operatori ekonomik Operatori ekonomik EVITA Shpk ka paraqitur në dokumentacionin e ofertës:*

- *deklaratë për mirëmbajtjen e aparaturave (Evita Vetedeklarim grafiku levrimit aparate)*
- *deklaratën për furnizimin dhe vendosjen në përdorim të aparaturave në gjendje pune*

*(Evita Vetedeklarim grafiku levrimit aparate)*

*Në këto deklarata operatori ekonomik merr përsipër që aparaturat:*

- të dorëzohen të gatshme për funksionim
- të shoqërohen me të gjithë komponentët dhe aksesoret e nevojshëm
- të mirëmbahen gjatë gjithë periudhës së kontratës

*Kjo përfshin edhe elektrodën dhe komponentët e tjerë teknikë të sistemit, të cilët zëvendësohen sipas ciklit të mirëmbajtjes. (elektrodën dhe aksesoret e nevojshëm jo vetëm që janë marrë përsipër dhe garantuar me deklaratën - Evita Vetedeklarim grafiku levrimit të mallit por, gjithashtu janë të pasqyruara dhe të markuara në katalog si aksesore - Evita Catalog 2012)*

*IV.*

*Referenca nga standardet ndërkombëtare laboratorike*

*Standardet dhe udhëzimet ndërkombëtare në fushën e biokimisë klinike dhe analizës së gazrave në gjak konfirmojnë dallimin midis reagentëve laboratorikë dhe komponentëve të aparaturës analitike.*

a. *Organizata ndërkombëtare International Federation of Clinical Chemistry and Laboratory Medicine (IFCC) në udhëzimet e saj për analizën e gazrave në gjak thekson se analizuesit modernë përdorin sensorë elektrokimikë të integruar (elektroda) për matjen e parametrave si pH, pCO<sub>2</sub>, pO<sub>2</sub> dhe elektrolitet.*

*Këta sensorë janë pjesë strukturore e aparaturës dhe funksionimi i tyre bazohet në kalibrimin periodik me solucione reference dhe buffer standard, të cilat konsiderohen reagentë të sistemit analitik.*

b. *Në manualin laboratorik Clinical Chemistry: Principles, Techniques, and Correlations thekson se analizuesit e gazrave në gjak përdorin solucione kalibrimi dhe solucione shpëlarjeje për të garantuar stabilitetin e elektrodave dhe saktësinë e matjeve analitike.*

*Në këto sisteme:*

- reagentët përbëhen nga solucione kalibrimi, buffer dhe solucione shpëlarjeje,
- ndërsa elektrodën janë sensorë elektrokimikë të integruar në aparaturë, të cilët kanë cikël zëvendësimi teknik dhe konsiderohen pjesë e mirëmbajtjes së instrumentit.

*Gjithashtu analizuesit e gazrave në gjak bazohen në teknologjinë e elektrodave selektive për jone (Ion-Selective Electrodes – ISE), të cilat përbëjnë elementin sensor të aparaturës dhe nuk klasifikohen si reagentë laboratorikë, ndërsa reagentët përbëhen nga solucionet e kalibrimit dhe bufferët standard*

*Në përputhje me këto referenca shkencore dhe me dokumentacionin teknik të prodhuesve të analizuesve laboratorikë, reagentët e sistemit analitik përfshijnë solucionet e kalibrimit dhe mirëmbajtjes së sistemit (si S1, S2 dhe S3), ndërsa elektrodën janë komponentë të aparaturës analitike dhe nuk përbëjnë pjesë të setit të reagentëve.*

c. *Në manualin laboratorik Clinical and Laboratory Standards Institute (CLSI) për analizën e gazrave në gjak dhe elektroliteve përshkruhet se:*

- elektrodën janë komponentë sensorë të aparaturës analitike,
- ndërsa reagentët e sistemit përfshijnë solucione kalibrimi, që përdoren për realizimin e testimit.

*Këto standarde laboratorike janë gjerësisht të përdorura në laboratorët klinikë dhe në projektimin e analizuesve të gazrave në gjak nga prodhuesit ndërkombëtarë të pajisjeve laboratorike.*

*Në përputhje me këto udhëzime dhe me dokumentacionin teknik të prodhuesit të aparaturës Cobas b221, solucionet e kalibrimit dhe mirëmbajtjes së sistemit (si S1, S2 dhe S3) përbëjnë reagentët e analizës, ndërsa elektrodën janë komponentë të aparaturës (janë të instaluar në aparat) dhe nuk klasifikohen si reagentë laboratorikë.*

*Për rrjedhojë, interpretimi i KVO që i konsideron elektrodën si pjesë të setit të reagentëve nuk përputhet me literaturën shkencore dhe me standardet ndërkombëtare të laboratorëve klinikë.*

*Konkluzioni shkencor*

Literatura shkencore dhe teknike në biokiminë klinike dhe inxhinierinë biomjekësore është konsistente në këtë pikë:

- Reagentët në analizuesit e gazrave në gjak janë solucionet e kalibrimit dhe bufferët standard.

- Elektrodat janë sensorë elektrokimikë të integruar në aparaturë që kryejnë matjen analitike dhe zëvendësohen vetëm si pjesë e mirëmbajtjes së sistemit.

Për rrjedhje, konsiderimi i elektrodave si pjesë e setit të reagentëve nuk përputhet me konfigurimin standard të analizuesve të gazrave në gjak dhe nuk mbështetet nga praktika e prodhuesve të pajisjeve laboratorike.

Në rastin konkret, oferta e operatorit ekonomik EVITA SHPK është përgatitur në përputhje me konfigurimin standard të sistemit me solucionet, sipas dokumentacionit teknik të prodhuesit Roche Diagnostics GmbH - Gjermani.

V.

Autoriteti kontraktor duhet të pranojë përbërjen e setit sipas specifikimeve teknike të prodhuesit të aparatit cobas b221

VI.

Sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, konkretisht Ligjit Nr. 162/2020 date 23.12.2020 "Per prokurimin publik", autoritetet kontraktore janë të detyruara të vlerësojnë ofertat vetëm mbi bazën e kriterëve të përcaktuara qartë në Dokumentet Standarde të Tenderit.

Nga analiza teknike dhe juridike rezultojnë se:

- operatori ekonomik EVITA Shpk ka paraqitur reagentët që përbëjnë setin e analizës sipas teknologjisë së aparaturës

- elektrodat janë komponentë të aparaturës dhe jo reagentë të setit (Dokumentat DoC bashkelidhur tregojnë që nuk janë reagent)

- Vendimi i KVO për skualifikimin e operatorit ekonomik është i pabazuar dhe duhet të shfuqizohet

Autoriteti kontraktor nuk mund të ndryshojë klasifikimin teknik të prodhuesit

Në fushën e pajisjeve laboratorike dhe biomjekësore, konfigurimi teknik i aparaturave dhe klasifikimi i komponentëve të tyre përcaktohet nga prodhuesi i pajisjes, në përputhje me dokumentacionin teknik dhe standardet ndërkombëtare të prodhimit.

Ky klasifikim përbën referencën kryesore teknike për mënyrën e funksionimit të pajisjes dhe për dallimin midis:

- komponentëve të aparaturës (sensorë, elektroda dhe elementë të sistemit analitik)

- reagentëve të analizës (solucione kalibrimi, buffer dhe solucionet mirëmbajtjeje)

Për analizuesit e gazrave në gjak, literatura shkencore dhe dokumentacioni teknik i prodhuesve konfirmojnë se elektrodat janë sensorë elektrokimikë të integruar në aparaturë, ndërsa reagentët përbëhen nga solucionet e kalibrimit dhe mirëmbajtjes së sistemit.

Në rastin konkret Aparatura Cobas b221, e prodhuar nga Roche Diagnostics, objekt i ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik EVITA Shpk, është një sistem analitik i projektuar dhe prodhuar sipas specifikimeve teknike të prodhuesit.

Në dokumentacionin teknik të prodhuesit përcaktohen qartë:

- komponentët strukturorë të aparaturës (Evita Katalog Cobas b 221 operator manual faqe 52; 62 (pika 11 e specifikimeve); 74-76; 265)

- materialet konsumuese të analizës

- procedurat e mirëmbajtjes dhe kalibrimit të sistemit Në këtë dokumentacion bëhet dallimi i qartë midis:

1. reagentëve të analizës, të cilët përbëhen nga solucionet e përdorura për kalibrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit (S1, S2 dhe S3), (Evita Katalog Cobas b 221 operator manual faqe 46-47; 124) dhe

2. komponentëve të aparaturës, të cilët përfshijnë sensorët elektrokimikë (elektrodat) dhe

*pjesët e tjera të sistemit analitik.*

*Ky klasifikim teknik është pjesë e projektimit të sistemit nga prodhuesi dhe nuk mund të ndryshohet apo interpretohet në mënyrë të ndryshme nga autoriteti kontraktor ose nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.*

*Për rrjedhojë, interpretimi i bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave që konsideron elektrodën si pjesë të setit të reagentëve përbën një riklasifikim teknik të komponentëve të aparaturës, i cili nuk mbështetet në dokumentacionin teknik të prodhuesit.*

*Në këto kushte, çdo vlerësim i ofertave duhet të bazohet në dokumentacionin teknik të prodhuesit dhe në standardet profesionale laboratorike, dhe jo në interpretime të ndryshme teknike që nuk mbështeten në këto burime dhe që nuk kanë impakt mbi objektin e prokurimit / vlerësimit të ofertës (analizat e astrupogramës / 276,000 teste / kosto për test).....”*

II.12. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 815/1 prot., datë 13.03.2026, me arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Evita” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 815 prot, datë 13.03.2026.

II.13. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se në përputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik është depozituar Formulari i paraqitjes së Argumentave nga operatori ekonomik “SWISSMED” SHPK, protokolluar me tonën nr.815/2, datë 17.03.2026

II.14. Nëpërmjet shkresës me nr. 3205/32 prot., datë 25.03.2026, protokolluar me tonën me shkresën nr. 815/3 prot., datë 27.03.2026, me objekt: “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Evita” SHPK lidhur me vlerësimin, në procedurën e prokurimit me nr.REF-64006-10-07-2025 me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj” është depozituar nga autoriteti kontraktor vendimi i KSHA-së nr.51/2026, datë 25.03.2026. Referuar këtij vendimi konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur pranim të plotë të ankesës.

II.15. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 01.04.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2026/6471, dhe nr. Protokollu 998/2026, datë 01.04.2026, e operatorit ekonomikë “SWISSMED” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashetëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për kualifikimin e operatorit ekonomik

“Evita” SHPK, si rrjedhojë e shqyrtimit nga KSHA të ankesës me nr. A/2026/6414, datë 12.03.2026 dhe me Nr. 815/2026 Prot., datë 13.03.2026 të operatorit ekonomik “Evita” SHPK

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “MEDFAU” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të tij nga procedura e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin se: *“Operatori ekonomik “MEDFAU” Shpk, Nipt J93610823R me dokumentacionin e paraqitur rezulton se nuk përmbush kërkesën 2.3.5 të kapacitetit teknik për kualifikim të përcaktuar në dokumentet e tenderit ku thuhet:*

*“Për të gjithë artikujt (kite, reagentë, materiale mjekësore etj.) e ofruar dhe që janë pjesë e setit sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike/specifikimi i materialeve), te paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej). Operatori ekonomik duhet të markoje në katalogun perkates produktet që ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te përcaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nepermjet sistemit elektronik të prokurimit”*

*Konkretisht në përmbushje të kriterit të sipërcituar operatori ekonomik ka paraqitur në SPE dokumentat me emërtimet “Katalogu RP500”, “Operator guide rp 500”, “Broshure rp500” në të cilin janë të përfshira të dhënat për artikujt të cilët janë pjesë e setit sipas dhe ofertës teknike të paraqitur nga OE në përmbushje të kriterit 2.3.15. Nga verifikimi i këtyre katalogjeve konstatohet që artikujt pjesë e setit nuk përmbushin të gjitha specifikimet teknike pasi nuk përfshijnë parametrin “UREA”, parametër ky i kërkuar në dokumentat standartë të kësaj procedure. Për sa më sipër “MEDFAU” Shpk, Nipt J93610823R skualifikohet.*

*2. Operatori ekonomik “MEDFAU” Shpk, Nipt J93610823R, me dokumentacionin e paraqitur rezulton se nuk përmbush kërkesën 2.3.7 të kapacitetit teknik për kualifikim të përcaktuar në dokumentet e tenderit ku thuhet: “Për pajisjet e astrupogramës (makinat e astrupogramës) të ofruara në përdorim, që do të shërbejnë për matjen e gazeve dhe elektroliteve në gjak, te paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej). Operatori ekonomik duhet të markoje në katalogun perkates produktet që ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te përcaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike*

*nepermjet sistemit elektronik te prokurimit”. Konkretisht në përmbushje të kriterit të sipërcituar operatori ekonomik ka paraqitur në SPE dokumentin me emërtimin “Katalog RP500”, “Broshure RP500”, “Operator GuideRP500” në të cilët janë të përfshira të dhënat për pajisjet e astrupogramës të ofruara në përdorim sipas dhe ofertës teknike të paraqitur nga OE në përmbushje të kriterit 2.3.15. Nga verifikimi i këtyre katalogjeve konstatohet që pajisjet e astrupogramës të ofruara në përdorim nuk përmbushin të gjitha specifikimet teknike pasi nuk përfshijnë kryerjen analizës së “UREA-s”, analizë kjo e kërkuar në shtojcën 6 të specifikimeve teknike të DST. Për sa më sipër “MEDFAU” Shpk, Nipt J93610823R skualifikohet”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën nr.8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 “kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

*“5. Për të gjithë artikujt (kite, reagentë, materiale mjekësore etj.) e ofruar dhe që janë pjesë e setit sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike/specifikimi i materialeve), te paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej). Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun perkates produktet që ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.”*

III.1.2. Në shtojcën nr.8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.7 “kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

*“7. Për pajisjet e astrupogramës (makinat e astrupogramës) të ofruara në përdorim, që do të shërbejnë për matjen e gazeve dhe elektroliteve në gjak, te paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej). Operatori ekonomik duhet te markojë ne katalogun perkates produktet që ofron sipas numrit rendor (te markuara sipas artikullit) te percaktuar ne formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetem ne forme elektronike nepermjet sistemit elektronik te prokurimit.”*

III.1.3. Në Shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumentave standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, të ndryshuar me shtojcën nr.3 në bazë të vendimit të KPP, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

#### **Shtojca 6.**

*[ Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]*

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

*Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me*

përrjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës. Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE:**

- Afati i skadencës për kitet, Data e skadencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës ose (minimalisht) një vit. Në raste të veçanta, sipas nevojave të argumentuara, për disa barna lejohet që sasi të cilat konsumohen për një periudhë jo më shumë se 3 muaj, afati i skadencës të jetë sa dyfishi i kohës së llogaritur për konsum".
- Konformitet me normat MDD 93/42/EEC sipas vlefshmërisë, ose Regulation (EU) 2017/475 on Medical Devices (the MDR) për sa është e aplikueshme, ose In-Vitro Medical Devices Directive (IVDD) 98/79/EC për sa është e aplikueshme, ose regjistrim FDA ose CE/DC (Deklarate konformiteti) kur është e aplikueshme sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse, origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit.
- Duhet të jenë të markuara CE
- Deklarate e ofertuesit mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese).
- Autorizim nga MAH / prodhuesi / Distributori i Autorizuar.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për artikujt e kërkuar në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emërtimi i katalogut të artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet përkatëse për produktet.
- Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimi për çdo artikull.

***Për sa i përket zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, OE/BOE i dalë fitues do të japë në përdorim të AK aparate astrupograme, pa kundërshpërblim, ku Kontraktori do të bëjë dhe do të garantojë mirëmbajtjen e tyre, pa asnjë pagesë shtesë për AK.***

*Pajisjet do të përdoren nga AK me qëllime 'matjen e gazeve dhe elektroliteve në gjak (astrupogramës)' ndaj pacientëve të QSU "Nënë Tereza", me kitet, reagentet dhe materialet mjekësore me të cilat OE/BOE do të ofertojë.*

*Huadhënësi do të bëjë mirëmbajtjen e aparaturave të dhëna në përdorim, me pjesë cilësore, te sigurta dhe origjinale, pa asnjë kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor deri në përfundim të kontratës së fundit të nënshkruar gjatë MK.*

*Sasia e makinave të astrupogramës që do të jepen në përdorim për AK, sipas shërbimeve pranë AK:*

<b><i>Sherbimet:</i></b>	<b><i>Nr. i Paj. Mjekësore në Përdorim:</i></b>
<i>Sherbimi kardiokirurgji</i>	<i>2 copë</i>
<i>Spitali infektiv</i>	<i>1 copë</i>
<i>Neuroshkenca</i>	<i>1 copë</i>
<i>Reanimacioni i Kardiologjise</i>	<i>1 copë</i>
<i>Terapi intesive pediatri</i>	<i>1 copë</i>
<i>Terapi intesive kirurgji</i>	<i>1 copë</i>
<i>Neurokirurgjia</i>	<i>1 copë</i>
<i>Urgjenca Semundjeve te brendshme</i>	<i>1 copë</i>
<i>Reanimacion i pergjithshem</i>	<i>1 copë</i>
<b><i>Sasia totale:</i></b>	<b><i>10 copë</i></b>

*Në rast defekti të mundshëm të njërit/disave prej aparateve të astrupogramës së ofruar në përdorim, makina/t do të ndërrohet/en menjëherë, me makinë tjetër (**back up-i**) të njëjtit model, minimumi me të njëjtat parametra dhe specifikime teknike, minimumi me të njëjtin vit prodhimi, të cilën operatori ekonomik e mban në gjendje **back-upi (minimalisht 1 makinë backup-i për 3 ose 4 makina aktive)**, për të garantuar mos-ndërprerjen e shërbimit nga Autoriteti Kontraktor.*

**SPECIFIKIMET TEKNIKE PER APARATET (Makinat e Astrupogramës):**

- Aparati duhet të kryej minimalisht këto analiza elektrolite (Na, K, Ca, Cl, mOsmol), gazet, ph, PO<sub>2</sub>, PCO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub>, HCO<sub>3</sub><sup>-</sup>, BE, Glu, Lac, Urea, Hct, Hb, bilirubinë totale, metHb,,
- Duhet të jetë në gjendje ti printojë të gjitha rezultatet.
- Duhet të ketë aftësinë për të vendosur disa parametra të pacientit, si psh: Temperaturën, Hemoglobinën FIO<sub>2</sub>, ID e pacientit, etj.
- Duhet të ketë një kontrollues temperature optimale prej 37<sup>0</sup> Celcius.
- Duhet të ketë një printer të brendshëm.
- Koha e analizimit nuk duhet të jetë më shumë se 120 sekonda.
- Sistemi duhet të bazohet në një teknologji kalibrimi nëpërmjet likuideve ose gazeve, ose me sistemin cartridge.
- Duhet të analizojë të gjithë gjakun dhe duhet të ketë shiringa dhe marrjen e mostrave për kapilarët.
- Duhet të ketë tastierë numerike (ose dixhitale / touch screen), ekran LCD (ose LED) dhe një printer të brendshëm.
- Duhet të ketë një memorie minimale të dhënash prej: minimumi 150 të dhëna pacientësh.
- Pajisja duhet të jetë e pajisur me të gjithë aksesorët standartë, elektrodën dhe kitet e start-up-it. Reagentët përkatës duhet të kenë jetëgjatësi jo më pak se 1 muaj.
- Energjia hyrëse: 220 VAC +10%, 50 HZ dhe gjithashtu duhet të ketë një UPS me kohë minimale pune prej jo më pak se 30 minuta, i cili duhet të furnizohet bashkë me analizatorin.
- Duhet të ketë një mundësi ruajtje të të dhënave në rast të ndonjë shpërndarje të energjisë elektrike
- Sistemi duhet të jetë ISO/CE ose US FDA i certifikuar.
- Duhet të paraqesë certifikatën e standardeve përkatëse IEC të sigurisë.
- Aparaturat duhet të jenë të reja (dhe të papërdorura).
- Aparaturat duhet të jenë prodhim i tre viteve të fundit.

III.1.4. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezultojnë, se operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK në përmbushje të kriterëve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- “katalog\_RP500”
- Broshure\_RP500
- operator\_guide\_RP500
- Oferta\_teknike\_RP500\_
- Oferta\_teknike\_SETI\_

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.1.6. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.1.7. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

- “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:
  - a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
  - b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
  - c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.
- 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.
- 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor

*mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.8. Në neni 80 “Parimet e procesit të për zgjedhjes”, pika 1/a të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

“1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;

b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të për zgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.”.

III.1.9. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të

kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.1.10. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.11. Në Shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kërkesat teknike për pajisjet objekt prokurimi, duke parashikuar ndër të tjera se aparati i astrupogramës duhet të kryejë minimalisht analizat për elektrolitet (Na, K, Ca, Cl, mOsmol), gazet, pH, PO<sub>2</sub>, PCO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub>, HCO<sub>3</sub><sup>-</sup>, BE, Glu, Lac, Urea, Hct, Hb, bilirubinë totale, metHb, si dhe të përmbushë edhe kërkesa të tjera funksionale e teknike që lidhen me printimin e rezultateve, vendosjen e parametrave të pacientit, kontrollin e temperaturës 37°C, printerin e brendshëm, kohën e analizimit jo më shumë se 120 sekonda, teknologjinë e kalibrimit, analizimin e gjakut total, memorien minimale të të dhënave, ruajtjen e tyre në rast ndërprerjeje të energjisë elektrike, furnizimin me UPS, certifikimet ISO/CE ose US FDA, standardet IEC të sigurisë, si dhe kushtin që aparaturat të jenë të reja, të papërdorura dhe prodhim i tre viteve të fundit.

Po kështu, në Shtojcën 8 “Formulari i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit”, pikat 2.3.5 dhe 2.3.7 “Kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka kërkuar paraqitjen e katalogëve teknikë për të gjithë artikujt e ofruar, si dhe për pajisjet e astrupogramës të ofruara në përdorim, me qëllim provimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike të kërkuara. Në këta katalogë duhej të përfshiheshin emërtimi dhe specifikimet teknike të detajuara për secilin

produkt të ofertuar, ndërsa operatori ekonomik kishte detyrimin të markonte produktet përkatëse sipas numrit rendor të formularit të ofertës. Katalogët do të pranoheshin vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK, në funksion të përmbushjes së këtyre kërkesave, ka paraqitur dokumentacionin teknik të emërtuar “katalog\_RP500”, “Broshure\_RP500”, “operator\_guide\_RP500”, “Oferta\_teknike\_RP500\_” dhe “Oferta\_teknike\_SETI\_”. Për pasojë, vlerësimi i përputhshmërisë së ofertës nuk mund të mbështetet në shqyrtimin e izoluar të një dokumenti të vetëm, por duhet të kryhet mbi bazën e leximit të plotë dhe të bashkëlidhur të gjithë dokumentacionit teknik të depozituar në SPE.

Komisioni konstaton se operatori ekonomik ankimues, për pajisjen e astrupogramës të ofruar në përdorim, ka ofertuar produktin e prodhuesit Siemens Healthineers, RAPIDPoint® 500e Blood Gas System, ndërsa për artikullin “Kite reagente elektroda për matjen e gazeve dhe elektroliteve” ka paraqitur dokumentacionin teknik përkatës nëpërmjet dokumentit “Oferta\_teknike\_SETI\_”.

Nga përmbajtja e njoftimit të skualifikimit të datës 19.02.2026 rezulton se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka mbështetur skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues në pretendimin se pajisja e ofertuar dhe artikujt pjesë e setit nuk përmbushin të gjitha specifikimet teknike, për shkak se nuk përfshijnë parametrin “UREA”, parametër ky i kërkuar shprehimisht në dokumentet e tenderit. Pra, shkak material i skualifikimit, sipas arsyetimit të vetë KVO-së, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ekskluzive me mungesën e pretenduar të këtij parametri.

Në shqyrtim të këtij shkak, Komisioni vëren se kërkesa e autoritetit kontraktor, sipas formulimit të saj në Shtojcën 6, nuk lidhet me nevojën që termi “UREA” të riprodhohet formalisht dhe në mënyrë identike në çdo dokument teknik të paraqitur nga operatori ekonomik, por me detyrimin që aparati i ofertuar të jetë në gjendje të kryejë minimalisht analizat e kërkuara, ndër të cilat përfshihet edhe ky parametër. Për rrjedhojë, objekti i vlerësimit duhet të jetë përmbajtja reale teknike e dokumentacionit të ofertës dhe jo një lexim thjesht literal, i ngushtë apo mekanik i tij.

Nga shqyrtimi i dokumentit “operator\_guide\_RP500”, të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni konstaton se në seksionin që lidhet me testimin e interferencës së laktatit, në faqen 452, evidentohet edhe urea. Kjo e dhënë teknike, e pasqyruar në dokumentacionin e vetë pajisjes së ofertuar, përbën provë objektive se parametri në fjalë trajtohet nga sistemi i ofertuar. Për pasojë, pretendimi i KVO-së se pajisja nuk përfshin parametrin “UREA” nuk rezulton i mbështetur në një shqyrtim të plotë dhe tërësor të dokumentacionit teknik të depozituar nga operatori ekonomik.

Komisioni gjykon se KVO ka kryer një interpretim të pjesshëm dhe të fragmentarizuar të dokumentacionit teknik, duke e shkëputur vlerësimin nga tërësia e provave të administruara në SPE. Një vlerësim i tillë nuk përputhet me detyrimin për shqyrtim objektiv të ofertës, për sa kohë dokumentacioni teknik duhet analizuar në kompleksitetin e tij dhe në funksion të provimit të përputhshmërisë reale të produktit me kërkesat e autoritetit kontraktor. Fakti që parametri urea rezulton i evidentuar në dokumentacionin teknik të pajisjes së ofertuar mjafton për të rrëzuar përfundimin e KVO-së mbi mungesën e tij.

Po kështu, Komisioni konstaton se në njoftimin e skualifikimit nuk janë evidentuar mospërputhje të tjera konkrete lidhur me kërkesat e tjera teknike të pajisjes, të tilla si koha e analizimit, memoria, sistemi i kalibrimit, ruajtja e të dhënave, UPS, printeri i brendshëm, certifikimet përkatëse apo gjendja e pajisjes. Për rrjedhojë, në kushtet kur vetë shkak i vetëm i artikuluar nga KVO për skualifikimin lidhet me mungesën e pretenduar të parametrin “UREA”, dhe ky shkak nuk provohet nga përmbajtja e dokumentacionit teknik të paraqitur, skualifikimi rezulton i pambështetur në prova dhe në lexim objektiv të ofertës.

Komisioni rithekson se kërkesat teknike dhe dokumentacioni provues i kërkuar nga autoriteti kontraktor kanë si qëllim garantimin e përmbushjes reale të nevojave funksionale të kontratës dhe jo aplikimin e një formalizmi të tepruar në shqyrtimin e ofertave. Për sa kohë operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK ka paraqitur dokumentacion teknik nga i cili rezulton se pajisja e ofertuar e përfshin parametrin UREA, atëherë kërkesa minimale përkatëse duhet konsideruar e përmbushur.

Për sa më sipër, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e mbështetur në mungesën e parametrin “UREA” nuk qëndron, moskonstatimi i saktë i përmbajtjes së dokumentacionit teknik ka sjellë një vlerësim të gabuar të ofertës ndaj pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

### **Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.**

III.2. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Evita” SHPK për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Referuar Vendimit të KSHA-së me nr. 51/2026, datë 25.03.2026, bashkëngjitur shkresës së autoritetit kontraktor me nr. 3205/32 prot., datë 25.03.2026, me objekt: “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Evita” SHPK lidhur me vlerësimin, në procedurën e prokurimit me nr.REF-64006-10-07-2025 me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, rezulton, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës, e ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik “Evita” SHPK.

III.2.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.2.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i cili parashikon shprehimisht se:

*1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

*a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:*

*i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;;*

*ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;*

*c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.*

*3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:*

*a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;*

*b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.*

Për sa më sipër, në kushtet kur operatorët ekonomikë të interesuar kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 115, të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të mos mbyllë çështjen, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Evita” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a dhe të vijojë shqyrtimin në themel të ankesës së operatorit ekonomik “Evita” SHPK.

III.2.2. Në shtojcën nr.8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.5 “kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

*“5. Për të gjithë artikujt (kite, reagentë, materiale mjekësore etj.) e ofruar dhe që janë pjesë e setit sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (Specifikimet teknike/specifikimi i materialeve), te paraqiten katalogje, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për secilin artikull (pjeset e katalogut që përmbajnë emertimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohet). Operatori ekonomik duhet të markoje në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor (të markuara sipas artikullit) të përcaktuar në formularin e ofertes. Katalogjet do pranohen vetëm në formë elektronike nepermjet sistemit elektronik të prokurimit.”*

III.2.3. Në shtojcën nr.8, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 2.3.15 “kapaciteti teknik”, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

*“15.Operatori ekonomik duhet te paraqese oferten teknike, per artikujt e kërkuar (për artikujt e përfshirë në SET si dhe për Makinat e Astrupogramës)\*, ne forme tabele, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe çertifikimet perkatese per produktet.*

*\*Sqarim: Operatori Ekonomik ofertues, në mënyrë që të konkludohet me një vlerësim sa më të saktë dhe mosdiskriminues nga AK, duhet të paraqesë 2 (dy) Oferta Teknike, ku njëra Ofertë Teknike pasqyron artikujt që janë pjesë e Set-it, objekt i kësaj kontrate, dhe një Ofertë Teknike tjetër për Makinat e Astrupogramës, që do të ofrohen në përdorim, dhe do ti shërbejnë AK për të vlerësuar drejtë përmbushjen e specifikimeve teknike për makinat e astrupogramës.”.*

III.2.4. Në Shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumentave standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, të ndryshuar me shtojcën nr.3 në bazë të vendimit të KPP, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

#### **Shtojca 6.**

*[ Shtojcë për t’u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]*

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

*Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.*

**SHËNIM:** *Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".*

*Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:*

*a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;*

b) *Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;*

c) *Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.*

*Skicimet, parametrat teknik etj:*

*Specifikimi i Materialeve:*

*Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:*

### **SPECIFIKIMET TEKNIKE:**

- *Afati i skadencës për kitet, Data e skadencës në ditën e lëvrimin të mallit duhet të jetë jo më e vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadencës ose (minimalisht) nje vit. Në raste të veçanta, sipas nevojave të argumentuara, për disa barna lejohet që sasisë të cilat konsumohen për një periudhë jo më shumë se 3 muaj, afati skadencës të jetë sa dyfishi i kohës së llogaritur për konsum".*
- *Konformitet me normat MDD 93/42/EEC sipas vlefshmërisë, ose Regulation (EU) 2017/475 on Medical Devices (the MDR) për sa është e aplikueshme, ose In-Vitro Medical Devices Directive (IVDD) 98/79/EC për sa është e aplikueshme, ose regjistrim FDA ose CE/DC (Deklarate konformiteti) kur është e aplikueshme sipas Direktivave dhe klasifikimit të Këshillit të Europës, bashkëlidhur me kopjet të certifikatave përkatëse, origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit.*
- *Duhet të jenë të markuara CE*
- *Deklarate e ofertuesit mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese).*
- *Autorizim nga MAH / prodhuesi / Distributori i Autorizuar.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për artikujt e kërkuar në formë tabele, ku të plotësohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanisë prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emërtimi i katalogut të artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i referencës së artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet përkatëse për produktet.*
- *Të respektohen specifikimet teknike të kërkuara nga shërbimi për çdo artikull.*

***Për sa i përket zhvillimit të kësaj procedure prokurimi, OE/BOE i dalë fitues do të japë në përdorim të AK aparate astrupograme, pa kundërshpërblim, ku Kontraktori do të bëjë dhe do të garantojë mirëmbajtjen e tyre, pa asnjë pagesë shtesë për AK.***

*Pajisjet do të përdoren nga AK me qëllime 'matjen e gazeve dhe elektroliteve në gjak (astrupogramës)' ndaj pacientëve të QSU "Nënë Tereza", me kitet, reagentet dhe materialet mjekësore me të cilat OE/BOE do të ofertojë.*

*Huadhënësi do të bëjë mirëmbajtjen e aparaturave të dhëna në përdorim, me pjesë cilësore, të sigurta dhe origjinale, pa asnjë kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor deri në përfundim të kontratës së fundit të nënshkruar gjatë MK.*

*Sasia e makinave të astrupogramës që do të jepen në përdorim për AK, sipas shërbimeve pranë AK:*

<b>Sherbimet:</b>	<b>Nr. i Paj. Mjekësore në Përdorim:</b>
Sherbimi kardiokirurgji	2 copë
Spitali infektiv	1 copë
Neuroshkenca	1 copë
Reanimacioni i Kardiologjise	1 copë
Terapi intesive pediatri	1 copë
Terapi intesive kirurgji	1 copë
Neurokirurgjia	1 copë
Urgjenca Semundjeve te brendshme	1 copë
Reanimacion i pergjithshem	1 copë
<b>Sasia totale:</b>	<b>10 copë</b>

Në rast defekti të mundshëm të njërit/disave prej aparateve të astrupogramës së ofruar në përdorim, makina/t do të ndërrohet/en menjëherë, me makinë tjetër (**back up-i**) të njëjtit model, minimumi me të njëjtat parametra dhe specifikime teknike, minimumi me të njëjtin vit prodhimi, të cilën operatori ekonomik e mban në gjendje **back-upi (minimalisht 1 makinë backup-i për 3 ose 4 makina aktive)**, për të garantuar mos-ndërprerjen e shërbimit nga Autoriteti Kontraktor.

#### **SPECIFIKIMET TEKNIKE PER APARATET (Makinat e Astrupogramës):**

- Aparati duhet të kryej minimalisht këto analiza elektrolite (Na, K, Ca, Cl, mOsmol), gazet, ph, PO<sub>2</sub>, PCO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub>, HCO<sub>3</sub><sup>-</sup>, BE, Glu, Lac, Urea, Hct, Hb, bilirubinë totale, metHb,,
- Duhet të jetë në gjendje ti printojë të gjitha rezultatet.
- Duhet të ketë aftësinë për të vendosur disa parametra të pacientit, si psh: Temperaturën, Hemoglobinën FIO<sub>2</sub>, ID e pacientit, etj.
- Duhet të ketë një kontrollues temperature optimale prej 37<sup>0</sup> Celcius.
- Duhet të ketë një printer të brendshëm.
- Koha e analizimit nuk duhet të jetë më shumë se 120 sekonda.
- Sistemi duhet të bazohet në një teknologji kalibrimi nëpërmjet likuideve ose gazeve ose me sistemin Cartridge.
- Duhet të analizojë të gjithë gjakun dhe duhet të ketë shiringa dhe marrjen e mostrave për kapilarët.
- Duhet të ketë tastierë numerike (ose dixhitale / touch screen), ekran LCD (ose LED) dhe një printer të brendshëm.
- Duhet të ketë një memorie minimale të dhënash prej: minimumi 150 të dhëna pacientësh.

- *Pajisja duhet të jetë e pajisur me të gjithë aksesorët standartë, elektrodën dhe kitet e start-up-it. Reagentët përkatës duhet të kenë jetëgjatësi jo më pak se 1 muaj.*
- *Energjia hyrëse: 220 VAC +10%, 50 HZ dhe gjithashtu duhet të ketë një UPS me kohë minimale pune prej jo më pak se 30 minuta, i cili duhet të furnizohet bashkë me analizatorin.*
- *Duhet të ketë një mundësi ruajtje të të dhënave në rast të ndonjë shkoputje të energjisë elektrike*
- *Sistemi duhet të jetë ISO/CE ose US FDA i certifikuar.*
- *Duhet të paraqesë certifikatën e standardeve përkatëse IEC të sigurisë.*
- *Aparaturat duhet të jenë të reja (dhe të papërdorura).*
- *Aparaturat duhet të jenë prodhim i tre viteve të fundit.*

III.2.5. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezultojnë, se operatori ekonomik “Evita” SHPK në përmbushje të kriterëve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

- *Evita\_Catalog\_2012*
- *Evita\_Katalog\_b221\_FQA*
- *Evita\_Katalog\_Cobas\_b\_221\_operator\_manual*
- *Evita\_Formulari\_Ofertes\_Teknike\_Aparat*
- *Evita\_Formulari\_Ofertes\_Teknike\_Seti\_reagenteve*

III.2.6. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

*“Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

III.2.7. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.

III.2.8. Në neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e

*nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

III.2.9. Në neni 80 “Parimet e procesit të përzgjedhjes”, pika 1/a të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

“1. Kontratat jepen mbi bazën e kriterëve të përcaktuara, pasi autoriteti ose enti kontraktor të ketë verifikuar që janë përmbushur të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) oferta përmbush kërkesat, kushtet dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin e kontratës ose në ftesën për ofertë dhe në dokumentet e tenderit, duke marrë në konsideratë, sipas rastit, variantet e paraqitura;

b) operatori ekonomik, që ka dorëzuar ofertën, përmbush kriteret e kualifikimit e të përzgjedhjes dhe nuk ndodhet në ndonjë nga situatat që përbëjnë shkak për skualifikim.”.

III.2.10. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 6, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.2.11. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka

në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.12. Referuar arsyes së s'kualifikimit të operatorit ekonomik "Evita" SHPK se *oferta teknike e paraqitur nuk përmban të gjithë artikujt që janë pjesë e setit pasi OE nuk ka listuar në këtë ofertë teknike "elektrodat" me anë të cileve kryhen matjet e parametrave referuar kjo dhe katalogut me emërtimin "Evita\_katalog\_Cobas\_221" të prodhuesit ROCHE ku përshkruhet procedura e matjes së parametrave. Gjithashtu për të përforcuar dhe më shumë këtë fakt sjellim në vëmendje dhe Listën e cmimeve të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik në të cilën konstatohet që artikujt përbërës të setit për një analizë janë "Kite reagente elektroda për matjen e gazrave dhe elektroliteve në gjak", cka konfirmon dhe njëherë që elektrodat janë të pjesë dhe për më tepër janë objekt faturimi dhe detyrimisht këto elektroda duhet të ishin listuar në ofertën teknike të paraqitur. Në përfundim të arsyetimit dhe fakteve të parashtruara më sipër gjykojmë që oferta teknike e paraqitur nga operatori ekonomik ofertues nuk përfshin të gjithë artikujt e setit sipas kërkesës në kriterin 2.3.15 sepse në të janë paraqitur vetëm artikujt "S1 Rinse Solution", i cili është solucion për larjen tubave dhe sistemit Cobas b 221, dhe "S2 Fluid Pack" dhe "S3 Fluid Pack A të cilët shërbejnë për kalibrim e pajisjes, për rrjedhojë "EVITA" Shpk, Nipt L31714005J nuk përmbush kriterin e sipërcituar..* Komisioni vëren se në Shtojcën 6 "Formulari i specifikimeve teknike" autoriteti kontraktor ka përcaktuar që *Sistemi duhet të bazohet në një teknologji kalibrimi nëpërmjet likuideve ose gazeve ose me sistemin Cartridge* cka do të thotë që teknologjia e kalibrimit mund ti referohet një ose më shumë metodatve ose metodës "Cartridge" ose nëpërmjet likuideve ose gazrave. Operatori ekonomik "Evita" SHPK nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar në SPE arrin të vërtetojë se mungesa e parametrave të elektrodave në listën e artikujve të përcaktuar në formularin e ofertës teknike nuk përbën shkak për skualifikimin e tij pasi parametri i elektrodave nuk është artikull më vete por është pjesë përbërëse e pajisjes që ky operator ka ofruar në ofertën e tij teknike. Në rastin konkret operatori ekonomik "Evita" SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në SPE ka arritur të plotësojë kërkesën e autoritetit kontraktor nëpërmjet likuideve.

Komisioni rithekson, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve

ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar në përputhje me kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, duke garantuar autoritetin kontraktor për përmbushjen me sukses të kontratës objekt-prokurimi. Në rastin konkret, KPP gjykon se operatori ekonomik “Evita” SHPK me dokumentacionin e paraqitur në SPE përmbush kriterin e vendosur në dokumentet e tenderit.

### **Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.**

III.3. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “SWISSMED” SHPK për shfuqizimn e vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës mbi pranimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Evita” SHPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik refuar arsyetimit të bërë në pikën III.2 e në vijim të këtij vendimi, vlerëson të mos e pranojë ankesën e operatorit ekonomik “SWISSMED” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “MEDFAUN” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Evita” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-

64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.

3. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “SWISSMED” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar, Mallra”, me nr. REF-64006-10-07-2025, me objekt “Blerje kite reagent dhe materiale mjekësore për analizat e matësit në gjak astrupograma (Set për një analizë) për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 muaj”, me fond limit: 83,904,000 (tetëdhjetë e tre milion e nëntëqind e katër mijë) lekë pa TVSH, ose 867,404 (tetëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e katër) Euro pa TVSH, zhvilluar në datë 02.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
4. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertat e operatorëve ekonomikë “MEDFAU” SHPK dhe “Evita” SHPK, sipas konstatimeve tëshprehura në këtë vendim duke i kyualifikuar ata
5. Ngarkohet zyra e financës të kryej veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “SWISSMED” SHPK.
6. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Evita” SHPK.
7. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MEDFAU” SHPK
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

